

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit		
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia		
Titulli i lëndës:	Statistikë Biznesore		
Niveli:	Baçelor		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I (i parë)		
Semestri:	II (i dytë)		
Numri orëve në javë:	3		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	USHAF		
Mësimdhënësi i lëndës:			
Detajet kontaktuese:			
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë do t'i njoftojë studentët me bazat e statistikës. Studentët do të njihen me mënyrat e grumbullimit të të dhënave, analizat statistikore të të dhënave, paraqitjen e të dhënave, teoritë e probabilitetit, leximin e tabelave të distribuimeve, treguesit e variacionit, analizën dinamike. Të gjitha njësitë e përfshira në këtë lëndë do të lidhen direkt me shembuj e diskutime në fushën ekonomike.		
Qëllimet e lëndës	Qëllimi i kësaj lënde është të pajisë studentët me njohuri themelore dhe shkathtësi në fushën e Statistikës, analizat statistikore dhe aplikimin e statistikës në biznes.		
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të këtij moduli, studentët do të jenë në gjendje të: 1. Dijë për metodat dhe teknikat e grumbullimit të të dhënave (1 ECTS) 2. Bëj caktimin e madhësisë së mostrës dhe përzgjedhjen e mostrës (1 ECTS) 3. Bëj prezentimin dhe analizat statistikore të të dhënave (2 ECTS) 4. Njeh dhe aplikon teorinë e probabilitetit (1 ECTS) 5. Njeh metoda të analizës dinamike të të dhënave: indekset dhe trendi. (1 ECTS)		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	8	8
Përgatitja për detyra projekte	1	5	5
Projekt kursi (planifikim + zbatim)	1	5	5
Detyra të shtëpisë	1	10	10

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			45												
Përgatitja përfundimtare në provim	2	10	20												
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	1	2												
Projektet, prezantimet etj	1	5	5												
Totali			150												
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Ligjerata dhe ushtrime të kombinuara dhe diskutime në klasë														
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në bazë të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Vijueshmëria dhe aktiviteti në mësim-----10 pikë (%) ➤ Përpilimi i një pyetësi-----10 pikë (%) ➤ Provimi final-----80 pikë (%) Kriteret e kalueshmërisë ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Vijueshmëria dhe aktiviteti në mësim – vlerësohet me 10 pikë (%) nga 100 pikët (%)e mundshme: • Vijueshmëria në mësim (5 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë i rregullt në ligjërata. • Aktiviteti (5 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktiv gjatë ligjëratave duke u angazhuar gjatë zgjidhjeve të detyrave në tabelë, duke u përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe përfitimi nga zgjidhja e detyrave në tabelë, zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulën e lëndës. 2. Përpilimi i një pyetësi - vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme: Brenda semestrit studenti duhet të përgatit një pyetësor (Word), i njëjti pyetësor do të realizohet në mes studentëve në ligjërata (sipas dëshirës mund të realizohet edhe jashtë Universitetit) dhe pastaj do të bëhet analizimi i të dhënave të mbledhura, përkitazi temave që mësohen. Tema e pyetësorit mund të propozohet nga profesori ose nga vet studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori. Rezultatet prezantohen para grupit.														
<table><tr><th colspan="2">Kriteret e vlerësimit të pyetësorit</th></tr><tr><th>Komponenti</th><th>Pikët (%)</th></tr><tr><td>Struktura dhe Qëllimi i pyetësorit</td><td>2</td></tr><tr><td>Përpilimi i pyetjeve</td><td>3</td></tr><tr><td>Analizimi dhe rezultatet e prezantuara</td><td>5</td></tr><tr><td>Gjithsej:</td><td>10</td></tr></table>				Kriteret e vlerësimit të pyetësorit		Komponenti	Pikët (%)	Struktura dhe Qëllimi i pyetësorit	2	Përpilimi i pyetjeve	3	Analizimi dhe rezultatet e prezantuara	5	Gjithsej:	10
Kriteret e vlerësimit të pyetësorit															
Komponenti	Pikët (%)														
Struktura dhe Qëllimi i pyetësorit	2														
Përpilimi i pyetjeve	3														
Analizimi dhe rezultatet e prezantuara	5														
Gjithsej:	10														

	Qëllimi: zhvillimi i aftësive për mbledhjen e të dhënave, analizimin dhe prezantimin e tyre. 3. Testi i provimit final, vlerësohet me 80 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme: Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuar nga senati i Universitetit. Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësim-nxënies të parapara në materialin e lëndës së ligjësuar. Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban: ◆ Pyetje teorike (një me zgjedhje dhe dy me përgjigje të shkurta) të cilat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....6 pikë (%) ◆ Pyetje me detyra (plotësim të tabelave, analizim të trendëve, etj)- për të cilat vet studenti duhet të jetë në gjendje të jap përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjësuar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit.....74 pikë (%) Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i tabelës smart, laptop, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	80% - Teori, 20% - Ushtrime praktike, Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (ushtrime me studente, kuize studentore në klase, etj) Nga gjithsej 150 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 80% me fokus në teori dhe 20% në praktikë.																												

	• 120 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologji dhe standarde të parapara në modulin e lëndës. • 30 orë janë të fokusuar në ushtrime praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup. Ndarja e 6 ECTS sipas raportit 80%-20% ❖ 5 ECTS (80%) i dedikohen pjesës teorike ❖ 1 ECTS (20%) i dedikohen pjesës praktike. Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.
Literatura	
Literatura bazë	1. Nuhiu, R. dhe Shala, A., 1995, Bazat e Statistikës, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë. 2. Braha, N., 2006, Bazat e Statistikës, Prishtinë
Literatura shtesë	1. Anderson, D., Sweeney, D. And Williams, T., 2005, Statistika, libër i përkthyer (Titulli: Statistics for Business and Economics) PEGI, Tiranë. 2. Kohler, H. (2002), Statistics for Business and Economics, Thomson Learning.
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantim i detajuar i syllabusit Metodat e punës dhe vlerësimi Hyrje në lëndën e Statistikës Biznesore Në këtë ligjëratë do të prezantojmë një hyrje për Statistikën (vetëm si koncept) si dhe temat të cilat do të mbulohen gjatë këtij kursi. Poashtu do të prezantohen dhe metodat e punës dhe metoda e vlerësimit.
Java e dytë	Hyrje në Statistikë. Konceptet kryesore të aplikimi i statistikës në biznes Në këtë ligjëratë do të paraqitet hyrja në statistikë duke u ndalur në kuptimin dhe historinë e statistikës, pastaj rëndësia e saj, objekti dhe metodat si dhe organizimi i statistikës. Rezultati i pritur nr. 1
Java e tretë	Elementet kryesore të analizës statistikore: dukuria masive dhe mostra. Llojet e të dhënave statistikore Në këtë ligjëratë do të paraqiten elementet kryesore të analizës statistikore: Dukuria masive- popullimi, njësia statistikore- individi, tipari statistikor, variacioni i tiparit dhe niveli i tiparit si dhe mostra. Pastaj llojet e të dhënave statistikore. Rezultati i pritur nr. 1 dhe 2
Java e katërt	Përcaktimi i madhësisë së mostrës, stratifikimi dhe teknikat e grumbullimit të të dhënave. Mënyrat e grumbullimit të të dhënave, përpilimi i pyetësorëve

	Në këtë ligjëratë do të paraqitet përcaktimi i vëllimit të mostrës, llojet e mostrave si dhe mënyrat e grumbullimit të të dhënave. Në pjesën e fundit të ligjëratës do të diskutohet për përpilimin e pyetësorëve si dhe do t'u jepet detyra për përpilimin e një pyetësoi. Rezultati i pritur nr. 1 dhe 2
Java e pestë	Paraqitja e të dhënave statistikore: rregullat kryesore për paraqitjen e të dhënave Në këtë ligjëratë do të paraqitet mënyra e paraqitjes së të dhënave statistikore. Paraqitja tabelare dhe ajo grafike. Rezultati i pritur nr. 3
Java e gjashtë	Frekuencat Në këtë ligjëratë do të paraqiten frekuencat: Frekuenca absolute, frekuenca komulative, frekuenca relative, frekuenca relative komulative dhe frekuenca në përqindje. Rezultati i pritur nr. 3
Java e shtatë	Analiza statistikore: mesatarja aritmetike, harmonike, dhe gjeometrike; mesorja, moda Në këtë ligjëratë do të paraqitet kuptimi, rëndësia dhe llojet e analizës statistikore. Madhësitë absolute dhe relative. Mesatarja aritmetike, moda, medianja, mesi gjeometrik dhe harmonik si dhe kuartilet (kur të dhënat janë të pagrupuara) (Tema e ligjëratës nga punimi shkencor) Rezultati i pritur nr. 3
Java e tetë	Analiza statistikore: mesataret e ponderuara dhe aplikimi i tyre në biznes Kjo ligjëratë do të jetë vazhdim i ligjëratës së kaluar këtu do të shohim dallimin në zgjidhje të detyrave kur të dhënat i kemi të grupuara. (Tema e ligjëratës nga punimi shkencor) Rezultati i pritur nr. 3
Java e nëntë	Treguesit e variacionit: devijimi standard; dispersioni; koeficienti i variancës; koeficienti i dispersionit; varianca relative Në këtë ligjëratë do të paraqiten treguesit absolut të variacionit: gjerësia e variacionit, shmangia mesatare absolute, shmangia mesatare kuadratike, devijimi standard dhe dispersioni. Rezultati i pritur nr. 3
Java e dhjetë	Indekset dhe treguesit tjerë ekonomik I Në këtë ligjëratë do të paraqiten indekset dhe treguesit tjerë ekonomik duke filluar me kuptimin dhe klasifikimin e indekseve dhe indekset individuale apo të thjeshta. Rezultati i pritur nr. 5

Java e njëmbëdhjetë	Indekset dhe treguesit tjerë ekonomik II: aplikimi i indekseve në biznes Kjo ligjëratë është vazhdim i ligjëratës së kaluar, ku do të vazhdohet me indekset agregare apo grupe dhe treguesit e tjerë relativ. Rezultati i pritur nr. 5
Java e dymbëdhjetë	Teoria e probabilitetit: nocionet themelore; probabiliteti i një dhe shumë ngjarjeve Në këtë ligjëratë do të paraqiten nocionet themelore të teorisë së probabilitetit: prova, ngjarja, probabiliteti i ngjarjes, probabiliteti me kusht, pavarësia, etj. Pastaj, probabiliteti i një dhe shumë ngjarjeve. Rezultati i pritur nr. 4
Java e trembëdhjetë	Teoria e probabilitetit: nocionet themelore; probabiliteti i një dhe shumë ngjarjeve Kjo ligjëratë është vazhdim i ligjëratës së kaluar, por këtu do të paraqiten vetëm detyra dhe ushtrime në teori të gjasës. Rezultati i pritur nr. 4
Java e katërbëdhjetë	Shpërndarja normale Në këtë ligjëratë do të paraqitet shpërndarja normale apo e Gauss-it, si dhe kthimi i saj në shpërndarja standarde normale. Rezultati i pritur nr. 3 dhe 4
Java e pesëmbëdhjetë	Analiza dinamike, trendet dhe regresioni i thjeshtë linear Në këtë ligjëratë do të paraqitet kuptimi dhe metodat e analizës dinamike, metoda grafike, metoda e mesatarës rrëshqitëse, metoda e lëkundjeve stinore dhe metoda e trendit. Rezultati i pritur nr. 5
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte nda j kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimmshënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimi me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	